



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i  
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General  
Secretary

Numër: 2-1648  
Datë: 23.07.2018

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 17 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Anulohet pjesërisht konkursi i publikuar në faqen zyrtare të MASHT me dt. 13.04.2018 për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve për të drejtën e aplikimit për OJQ, persona juridik dhe ndërmarrje, ndërsa mbetet në fuqi pjesa e konkursit për personat fizik.
2. Shfuqizohet Vendimi me nr. 2-1628 i dt. 18.07.2018.
3. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e sekretarit të përgjithshëm.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, në funksion të zbatimit të Rregullores MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve me të cilën janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ dhe është e ndryshme me Udhëzimin administrativ të MASHT-it nr. 21/2016 për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, në bazë të cilit është shpallur konkursi i dt. 13.04.2018, si dhe në bazë të njoftimit të Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve për subvencione, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të ministrit;
2. Zyrës së SP;
3. Komisionit
4. Arkivit.

Ekrem Kastrati, sekretar i përgjithshëm

